



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ, Nr-27/20112, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 26.03.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet plani vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën prill-dhjetor për vitin 2026, (në tekstin e mëtejme KKSB).

Neni 2

Pjesë përbërse e këtij vendimi është plani i veprimit për këshillin komunal për siguri në bashkësi për periudhën prill-dhjetor 2026, i hartuar nga Koordinator i këshillit komunal për siguri në bashkësi në bashkpunim me anëtarët e këshillit komunal për siguri në bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës njëherit Kryesues i këshillit komunal për siguri ne bashkësi dhe Koordinator i këshillit komunal për siguri ne bashkësi në tekstin e mëtejme (KKSB).

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-13481
Me datë 26.03.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI